



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 57

2003

Korrik

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9046 datë 3.4.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për ndërtimin e godinës së komandës dhe të mjediseve të akomodimit të personelit, si dhe thellimin e kanalit hyrës dhe të basenit të bazës detare të Bishtit të Pallës”.....	2417
Ligj nr.9080 datë 12.6.2003	Për një ndryshim në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore".....	2421
Ligj nr.9084 datë 19.6.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave....	2422
Ligj nr.9085 datë 19.6.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”.....	2431
Ligj nr.9086 datë 19.6.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.....	2432

Dekret nr.3875 datë 2.7.2003	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2434
Dekret nr.3876 datë 2.7.2003	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2435
Vendim i KM nr.456, datë 3.7.2003	Për strukturën dhe nivelet e pagave të punonjësve të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	2436
Vendim i KM nr.457, datë 3.7.2003	Për miratimin e Memorandumit të mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit “Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003”.....	2437
Vendim i GJK nr.20, datë 2.7.2003	Shfuqizimin e vendimeve nr.1458, datë 20.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1006, datë 24.9.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1952, datë 19.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	2439
Udhëzim i KQZ nr.1, datë 11.7.2003	Mbi procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, 2003.....	2442

L I G J
Nr.9046, datë 3.4.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR NDËRTIMIN E GODINËS SË KOMANDËS DHE TË MJEDISEVE TË AKOMODIMIT TË PERSONELIT, SI DHE THELLIMIN E KANALIT HYRËS DHE TË BASENIT TË BAZËS DETARE TË BISHTIT TË PALLËS”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës të Greqisë për ndërtimin e godinës së komandës dhe të mjediseve të akomodimit të personelit, si dhe thellimin e kanalit hyrës dhe të basenit të Bazës Detare të Bishtit të Pallës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MARRËVESHJE

NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR NDËRTIMIN
E GODINËS SË KOMANDËS DHE TË MJEDISEVE TË AKOMODIMIT TË PERSONELIT, SI
DHE THELLIMIT TË KANALIT HYRËS DHE TË BASENIT TË BAZËS DETARE TË BISHTIT
TË PALLËS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës të Shqipërisë, e cila në vazhdim do të quhet “Pala shqiptare” dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës të Greqisë, e cila në vazhdim do të quhet “Pala greke” dhe që të dyja së bashku do të quhen “Palë”:

duke pasur parasysh Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës të Greqisë që u nënshkrua në Athinë, më 7 nëntor 1992;

duke pasur parasysh Protokollin për Ndihmën dhe Bashkëpunimin për Forcat e Armatosura ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës të Greqisë që u nënshkrua në Tiranë, më 5 gusht 1997,

Palët ranë dakord si më poshtë.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe përgjegjësitë e të dyja Palëve në lidhje me fillimin dhe përfundimin e ndërtimit të komandës dhe të mjediseve të akomodimit të Bazës Detare të Bishtit të Pallës, si dhe thellimin e kanalit hyrës e të basenit të ankorimit të bazës detare të lartpërmendur, me shpenzimet e Palës greke.

Neni 2

Përmbajtja

Kjo Marrëveshje do të plotësojë:

- a) statusin e veprimtarisë dhe personelit të Palës greke, që do të sigurojë asistencë për kryerjen e punëve të lartpërmendura;
- b) përgjegjësitë e përgjithshme të Palës greke;
- c) përgjegjësitë e përgjithshme të Palës shqiptare;
- d) përshkrimin e përgjithshëm të punëve që do të zbatohen;
- e) detaje të procedurës për përpunimin dhe miratimin e studimeve teknike përkatëse;
- f) grafikun e punimeve të ndërtimit;
- g) buxhetin dhe burimet e financimit;
- h) Pala greke do të sigurojë personelin, që do të ketë autoritetin dhe përgjegjësinë e mbikëqyrjes së punimeve dhe të koordinimit të aktiviteteve me Palën shqiptare. Personeli i Palës greke nuk duhet të kalojë numrin 10 persona civilë dhe ushtarakë, të cilët nuk do të jenë të përhershëm, por do të kenë autoritetin dhe përgjegjësitë e përmendura më sipër;
- i) përgjegjësitë e të dyja Palëve lidhur me përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.

Neni 3

Statusi i aktiviteteve dhe personelit të Palës greke në Shqipëri

Statusi dhe parimet, që do të zbatohen në aktivitetin për ndërtimin e Bazës Detare të Bishtit të Pallës, për transportimin e makinerive dhe pajisjeve të nevojshme, statusi dhe siguria e personelit të Palës greke, që do të asistojë Palën shqiptare të përfundojë punimet, do të sigurohen nga Marrëveshja NATO PFP/SOFA.

Neni 4

Përgjegjësitë e Palës greke

Pala greke duhet:

- a) të paraqesë listat e personelit dhe të mjeteve të transportit që do të përdoren gjatë punimeve;
- b) të japë përshkrimin teknik dhe grafikun e punimeve që do të zbatohen;
- c) të sigurojë personelin e nevojshëm dhe pajisjet për përfundimin e punimeve, sipas specifikimeve teknike (inxhinierë, punëtorë etj.);
- d) të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të zbatuar grafikët kohorë të punimeve;
- e) të instalojë kantierin e ndërtimit për të bërë të mundur zbatimin e punimeve.

Neni 5

Përgjegjësitë e Palës shqiptare

Pala shqiptare duhet:

- a) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar hyrjen e lirë dhe transportin e personelit të Palës greke dhe të kontraktorëve në zonën e punimeve;
- b) të vërë në dispozicion të Palës greke zonat e punimeve, sipas limiteve kohore të përcaktuara nga Palët dhe të njoftojë me shkrim për këtë përfaqësuesit e Palës greke;
- c) të sigurojë lehtësira për procedurat e kalimit për punëtorët e firmës kontraktuese, jo më vonë se 10 ditë nga marrja e listës së emrave nga kontraktori;
- d) të sigurojë çdo asistencë të mundshme për zhvillimin normal të punimeve;
- e) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur pajisjet dhe materialet gjatë transportit dhe përdorimit në Shqipëri;
- f) të sigurojë kantierin e punimeve me lehtësira si ujë, elektricitet etj., jo më vonë se 10 ditë nga data e kërkesës përkatëse;
- g) të caktojë një oficer, i cili të sigurojë komunikimin ndërmjet Palëve në gjuhën angleze ose në greqisht;

h) të krijojë një komision për kontrollin dhe pranimin e punimeve, si dhe për marrjen në dorëzim pas përfundimit të tyre.

Neni 6 Punimet

Ndërtesa e komandës dhe e mjediseve të akomodimit, afërsisht 1.600 m², do të ndërtohet në Bazën Detare të Bishtit të Pallës. Ajo do të pajiset me sistem elektrik, sistem ngrohjeje, furnizim me ujë të ngrohtë dhe ajër të kondicionuar të zyrave, për të plotësuar kërkesat akomoduese për personelin ushtarak të Palës shqiptare. Asnjë mobileri ose dekoracion nuk do të sigurohet me përjashtim të materialeve ndërtimore normale.

Gjatë punimeve për thellimin e kanalit hyrës në port dhe të basenit të Bazës Detare, kanali hyrës dhe baseni ujqor i bazës do të thellohet sipas projektit të thellimit të paracaktuar nga specialistë të Palës shqiptare për një lundrim dhe ankorim të sigurt të anijeve. Kantieri i punimeve do të instalohet nga Pala greke.

Neni 7 Përgatitja, studimi dhe miratimi i projekteve

Punimi i studimeve do të përgatitet nga Pala greke duke respektuar legjisllacionin e brendshëm të të dyja Palëve. Pala greke do të marrë në konsideratë aplikimin e ligjit shqiptar.

Pala greke do të sigurojë informacionin e nevojshëm për grupin e studimit të projekteve.

Projekti i përgatitur nga Pala greke, do të zbatohet pas miratimit me shkrim nga Pala shqiptare.

Neni 8 Grafiku i punimeve

Pala greke do të kryejë punimet si më poshtë:

- a) përgatitja e projekt-studimit dhe përfundimi i punimeve parapërgatitore;
- b) përgatitja e studimit përfundimtar;
- c) plani e punës;
- d) punimet e ndërtimit;
- e) pranimi i punimeve.

Pala greke do të përzgjedhë një firmë private ndërtuese greke për kryerjen e punimeve, në përputhje me legjisllacionin grek.

Pala shqiptare do të informohet për grafikun e punimeve pas përgatitjes së studimit përfundimtar.

Neni 9 Buxheti

Pala greke do të përcaktojë fondet e nevojshme për kryerjen e punimeve. Buxheti total për ndërtimin e ndërtesës së komandës dhe të mjediseve të akomodimit, si dhe thellimit të kanalit hyrës dhe të basenit të Bazës Detare të Bishtit të Pallës, do të jetë afërsisht 5.5 milionë euro. Shuma e saktë e vlerës së preventivit do të përcaktohet pas përfundimit të studimeve përkatëse.

Të gjitha materialet, pajisjet që do të vijnë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë në formën e ndihmave dhe të dhuratave, duke u përjashtuar nga të gjitha taksat e Shtetit shqiptar. Për personelin shqiptar të punësuar në firmën private ndërtuese, Pala greke do të marrë përsipër pagën mujore.

Neni 10 Detyrimi i të dyja Palëve në lidhje me përdorimin dhe ruajtjen e pajisjeve dhe të mjediseve

Pas marrjes në dorëzim të ndërtesës së komandës dhe të mjediseve të akomodimit të Bazës

Detare të Bishtit të Pallës, nuk do të lejohet asnjë rindërtim, pa një studim të miratuar nga Pala shqiptare dhe me marrjen e pëlqimit nga Pala greke.

Inspektimi i ndërtesës së komandës dhe të mjediseve të akomodimit të Bazës Detare të Bishtit të Pallës, për të përcaktuar gjendjen e saj pas punimeve dhe brenda garancisë, do të kryhet nga Pala greke. Dëmtimet e mundshme të bëra pas 15 muajve të përfundimit të garancisë së punimeve, do të riparohen me shpenzimet e Palës shqiptare.

Përdorimi i pajisjeve dhe i mjediseve nuk lejohet për institucione të tjera, përveç Forcave Detare Shqiptare.

Neni 11

Personeli i Palës greke që do të bashkëpunojë me Palën shqiptare për zbatimin e punimeve

Pala greke do të caktojë një oficer ndërlidhës gjatë përgatitjes së studimeve dhe zbatimit të punimeve.

Anijet e flotës greke, të cilat do të vizitojnë zonën për qëllim trajnimi operacional ose në kuadrin e marrëdhënieve dypalëshe ose gjatë operacioneve Pfp/CRO ose NATO, do të kenë të drejtë të ankorohen në bazë dhe të përdorin vendankorimin dhe të kryejnë riparime lehtësuese, pas njoftimit me shkrim.

Detajet për prezencën e anijeve të flotës greke në bazë, do të përcaktohen në një protokoll të veçantë bashkëpunimi midis flotave shqiptare dhe atyre greke.

Neni 12

Ndryshimet

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen me mirëkuptim në çdo kohë me kërkesën e secilës Palë. Çdo ndryshim do të hyjë në fuqi sipas procedurave të përcaktuara në nenin 15 dhe do të përbëjë pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet drejtpërdrejt nga Palët nëpërmjet konsultave reciproke. Kur Palët nuk bien dakord, ato do t'i referohen marrëveshjes NATO Pfp/SOFA.

Neni 14

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar

Palët janë të detyruara të mbrojnë çdo informacion që do të përfitohet nga takimet dypalëshe, duke përfshirë dhe të dhënat sekrete. Palët detyrohen të mos i përdorin dhe të mos i japin ato palëve të treta, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës që i disponon këto informacione.

Informacionet gojore dhe të shkruara të përfituara në takimet dypalëshe do të ruhen, sipas shkallëve të klasifikimit, përcaktuar në legjislacionin në fuqi të secilës Palë dhe nuk do të publikohen në media.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas marrjes së njoftimit reciprok të Palëve, të cilat informojnë njëra-tjetrën në lidhje me përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Neni 16

Kohëzgjatja dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë kohore prej 5 vjetësh. Rinovimi bëhet

automatikusht për një vit në qoftë se Palët nuk vendosin ndryshe.

Nënshkruar në Tiranë, më 30.12.2002, hartuar në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, greke dhe angleze. Në rast se konstatohen ndryshime në këto gjuhë, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

PËR MINISTRINË E MBROJTJES TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR MINISTRINË E MBROJTJES KOMBËTARE
TË REPUBLIKËS SË GREQISË

Pavli Zëri
Zëvendësministër i Mbrojtjes

Lotidis Lazaros
Zëvendësministër i Mbrojtjes Kombëtare

L I G J
Nr.9080, datë 12.6.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8981, DATË 12.12.2002
"PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE"

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", në faqen 133 bëhet ky ndryshim:

" Kodi NC|Përshkrimi|Tarifa(%)
2203 00|Birrë e bërë nga malti:|
|- Në kontenierë që mbajnë 10 litra ose më pak: |
2203 00 01 |- Në shishe|20
2203 00 09 |- Të tjera|20
2203 00 10|- Në kontenierë që mbajnë më shumë se 10 litra|20"

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3878, datë 2.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9084, datë 19.6.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8610, DATË 17.5.2000 "PËR
PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE"**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

**"Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e pastrimit të produkteve të veprave penale dhe të kryerjes së veprimtarive kriminale në fushën ekonomike dhe financiare.”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. "Pastrimi i parave" është qarkullimi ose riqarkullimi i parave, që rrjedhin nga veprat penale, si edhe këmbimi, transferimi, transformimi ose tjetërsimi i produkteve dhe i pasurive, të rrjedhura nga veprat penale, me qëllim fshehjen e burimit ose të origjinës së tyre të paligjshme.

Pastrimi i parave përfshin:

a) këmbimin ose transferimin e pasurisë, kur dihet se është produkt i veprës penale, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të pasurisë ose dhënien e ndihmës personit të përfshirë në kryerjen e veprës penale, për t’iu shmangur pasojave juridike të veprimit të tij;

b) fshehjen ose mbulimin e natyrës, të burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes së pronësisë së vërtetë ose të të drejtave që lidhen me pasurinë, kur dihet ose duhet të dihet se pasuria është produkt i veprës penale;

c) fitimin, zotërimin ose përdorimin e pasurive, kur në kohën e marrjes dihej ose duhej të dihej se pasuria ishte produkt i veprës penale;

ç) pjesëmarrjen, bashkëpunimin në kryerje, tentativën për të kryer dhe ndihmën, përkrahjen, lehtësimin dhe këshillimin në kryerjen e secilës prej veprimtarive të përcaktuara më sipër;

d) kryerjen e veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas dispozitave të këtij ligji;

dh) pastrim parash do të konsiderohet edhe rasti kur veprimtaria kriminale, nga e cila rrjedh pasuria, është kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Fjala e parë e pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. "Autoriteti përgjegjës" është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në varësi të Ministrit të Financave.”.

Pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

"6. "Produkt i veprës penale" është çdo pasuri e ardhur ose instrument ligjor, sipas përcaktimeve të nenit 36 të Kodit Penal.

7. "Pasuri" janë pasuritë dhe asetet e çdo lloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, materiale ose jomateriale, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore, që vërtetojnë tituj ose interesat në këto pasuri.”.

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) bursat, agjentët e bursës;".

Shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

"dh) Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe çdo institucion ose person tjetër juridik, që kryen veprime juridike të tjetërsimit dhe dhënies në përdorim të pronës shtetërore ose që kryen evidencimin, transferimin ose tjetërsimin e pasurive;".

Shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:

"e) shërbimet postare, ndërmjetësuesit e tjerë, që kryejnë shërbime pagesash, si dhe çdo person fizik ose juridik, që kryen veprime këmbimi ose transferim fondesh apo dhënie kredie;".

Në fund të shkronjës "f" shtohen fjalët "zyrat e konsulencës dhe ekspertët kontabël të miratuar;".

Nënparagrafi i fundit i shkronjës "g" ndryshohet si më poshtë:

"- ndërtime;".

Shkronja "h" ndryshohet si më poshtë:

"h) organizatat jofitimprurëse;".

Shkronja "j" ndryshohet si më poshtë:

"j) zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;".

Pas shkronjës "j" shtohet shkronja "k" me këtë përmbajtje:

"k) agjencitë e udhëtimit;".

Neni 4

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime e shtesa:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Të gjitha subjektet e këtij ligji identifikojnë klientët, përpara kryerjes së veprimit financiar mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji.

Subjektet identifikojnë klientët edhe në rastet kur ka të dhëna ose dyshime të bazuara, në fakte e rrethana konkrete, për pastrim parash, megjithëse shuma e veprimit financiar mund të jetë poshtë kufijve të përcaktuar në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji.

Subjektet e përcaktuara në shkronjat "d", "ë" dhe "k" të nenit 3 të këtij ligji regjistrojnë veprimet e klientit, duke filluar nga shuma 200 000 (dyqind mijë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera dhe raportojnë çdo veprim të dyshimtë për pastrim parash.

Në bazë dhe në zbatim të këtij ligji, institucionet financiare përmbushin edhe veprimet e identifikimit dhe raportimit të caktuara nga Banka e Shqipërisë, lidhur me parandalimin e pastrimit të parave;".

Në pikën 2, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Rregulla të hollësishme lidhur me formën dhe procedurën e regjistrimit të të dhënave për zbatimin e këtij ligji caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave;".

Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Të gjithë klientët që synojnë të kryejnë një transaksion me vlerë mbi shumën e parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, bëjnë deklarinë e përfituesit, të burimit të kësaj shume dhe të natyrës e masës së të ardhurave të siguruara nga qarkullimi i parave;".

Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Të dhënat e siguruara në përputhje me këtë nen i dërgohen autoritetit përgjegjës dhe organeve të tjera shtetërore të ngarkuara me përmbushje të detyrimeve, sipas këtij ligji;".

Neni 5

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime e shtesa:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Subjektet e përcaktuara në këtë ligj regjistrojnë të gjitha veprimet financiare të të gjithë

klientëve, duke filluar nga shuma 2 000 000 (dy milionë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera, të huaja.

Subjektet regjistrojnë dhe bëjnë raportimin pranë autoritetit përgjegjës për çdo veprim financiar edhe nën vlerat e përcaktuara në këtë ligj, në rastet kur ka të dhëna ose dyshime të bazuara, në fakte e rrethana konkrete, për pastrim parash.

Pas regjistrimit të këtyre veprimeve, në rast se ka elemente të dyshimit për pastrimin e parave, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, subjektet i raportojnë autoritetit përgjegjës."

Në pikën 2, rreshti i tretë shifrat dhe fjalët "70 000 000 (shtatëdhjetë milionë)", zëvendësohen me shifrat dhe fjalët "20 000 000 (njëzet milionë)".

Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Subjektet e parashikuara në këtë ligj bëjnë regjistrimin dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës të gjitha transaksionet e klientëve të tyre, pavarësisht nga shuma e tyre, në rastet kur vërejnë:"

Në pikën 3, pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) se kryhen disa transaksione të njëpasnjëshme ose të lidhura me njëra-tjetrën, shuma e të cilave e kalon vlerën e caktuar në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji."

Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të ligjit duhet menjëherë të njoftojnë autoritetin përgjegjës në çdo rast kur kanë informacion ose dyshime që një transaksion, produkt dhe pasuri ka si burim, rrjedh ose është përdorur, si dhe synohet të përdoret për të rritur mbështetjen, lehtësuar, ruajtur, nxitur ose fshehur aktet terroriste ose financimin e terrorizmit."

Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Subjektet e këtij ligji i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për të gjitha rastet e parashikuara më sipër në këtë nen, si dhe për çdo të dhënë tjetër, që pohon ose mohon, të dhëna ose dyshime, të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete, për pastrim parash. Në rastet e parashikuara në pikën 3/1 të këtij neni, raportimi bëhet menjëherë në çastin e regjistrimit të veprimeve dhe transaksionit."

Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Rregulla të hollësishme lidhur me formën dhe procedurën e verifikimit dhe raportimit të të dhënave në zbatim të këtij ligji caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave."

Neni 6

Në nenin 6 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 1, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"1. Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, subjektet e përcaktuara në nenin 3 të tij, punonjësit dhe drejtuesit e çdo niveli të tyre, që ngarkohen me raportimin e transaksioneve të dyshimta, sipas dispozitave të këtij ligji, si dhe çdo autoritet tjetër, ndalohen të njoftojnë personat e përfshirë në transaksion për verifikimin dhe raportimin e këtij transaksioni, si dhe t'i bëjnë të ditur klientit të tyre çdo lloj informacioni tjetër të lidhur me dyshimin e pastrimit të parave."

Në pikën 1, pas shkronjës "b" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Subjektet kanë barrën e provës-detyrimin para autoritetit përgjegjës dhe/ose organeve të procedimit, për të vërtetuar origjinën e ligjshme të të ardhurave ose të pasurive të tjera, që janë objekt konfiskimi."

Në pikën 2, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"2. Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, subjektet e përcaktuara në nenin 3 të tij, si dhe punonjësit e drejtuesit e çdo niveli të tyre janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e autoritetit përgjegjës, sipas nenit 8 shkronja "e" të këtij ligji, si dhe të mos kryejnë veprime financiare në rast se:"

Pas shkronjës "c" shtohen shkronjat "ç" dhe "d" me këtë përmbajtje:

"ç) nuk sigurohet identifikimi i përfutuesit;

d) nuk deklarohet burimi."

Neni 7

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Nenit 7 të ligjit i vendoset titulli si më poshtë:

“Masat parandaluese të subjekteve”.

Shkronja “dh” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“dh) të ngarkojnë kontrollin e brendshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të hartojnë programe kontrolli për testimin e sistemit;”.

Pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “ë”, “f” dhe “g” me këtë përmbajtje:

“ë) t’i dërgojnë të dhëna, të dhëna shtesë dhe dokumente autoritetit përgjegjës, sipas kërkesave dhe në afatet e përcaktuara prej tij. Kur ka arsye të bazuara se afati i caktuar është i pamjaftueshëm, kërkohet zgjatja e tij, por jo më shumë se 15 ditë nga marrja e kërkesës;

f) të parandalojnë çeljen e llogarive bankare anonime ose me emra fiktivë;

g) të bëjnë identifikimin e klientëve dhe të regjistrojnë të dhënat rreth veprimeve financiare të tyre, duke miratuar dhe zbatuar edhe rregulla të brendshme për evidentimin dhe mbajtjen e përditshme të të dhënave për veprimet që klientët kryejnë pranë tyre.”.

Neni 8

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës, sipas këtij ligji, si një institucion qendror në varësi të Ministrit të Financave. Kjo drejtori, brenda fushës së veprimtarisë së saj, ka të drejtën të vendosë vetë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave.

2. Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, kjo Drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave.

3. Marrëdhëniet e punës të kësaj Drejtorie rregullohen me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

4. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të saj përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 9

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e autoritetit përgjegjës

Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji, autoriteti përgjegjës ka këto detyra dhe të drejta:

mbledh raportet dhe të dhënat nga subjektet, sipas përcaktimeve të bëra me ligj;

ka akses në të dhënat e administruara nga organet shtetërore dhe çdo regjistër publik;

analizon raportet dhe të dhëna të tjera të marra nga subjektet e këtij ligji dhe organe të tjera shtetërore për të identifikuar klientët, përfituesin dhe burimin e transaksionit financiar;

ç) kërkon të dhëna shtesë nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, që lidhet me rastin për identifikimin e klientit dhe të përfaqësuesit të tij, të personave në emër të të cilëve janë çelur llogaritë ose janë drejtuar transaksionet dhe burimet e të ardhurave;

bashkëpunon me njësi të tjera të specializuara financiare dhe me institucione të interesuara, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e të dhënave për identifikimin, zbulimin e burimeve, bllokimin dhe ngrirjen e përkohshme të transaksioneve të ndryshme dhe për sekuestrimin e produkteve të veprave penale;

dh) zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi dhe ndjek zbatimin e procedurave dhe mekanizmave për të informuar njësitë e specializuara financiare dhe autoritete të tjera të caktuara jashtë vendit,

lidhur me të dhëna dhe dokumente që zotëron, si dhe për të kërkuar nga këto të fundit të dhëna dhe dokumente, me qëllim zbulimin dhe hetimin e veprimtarive të kundërligjshme të pastrimit të parave;

u shpërndan të dhëna dhe raporte autoriteteve të tjera përkatëse për investigimin, hetimin dhe procedimin e individëve, në rastet kur dyshohen për pastrim parash;

ë) urdhëron, kur ka arsye, të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete, për pastrim parash, bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë;

dërgon në organin e prokurorisë kopje të aktit, me të cilin ka vendosur bllokimin dhe ngrirjen e përkohshme të transaksioneve dhe veprimeve, sipas shkronjës “ë” të këtij neni;

kallëzon në organin e prokurorisë, kur vlerëson se janë fakte të mjaftueshme për veprën penale të pastrimit të parave;

gj) kërkon dhe realizon këshillime me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me verifikimin dhe hetimin e rasteve komplekse të pastrimit të parave;

h) mban, administron dhe ruan të dhënat dhe dokumentacionin tjetër ligjor për veprimet financiare, për një afat prej 10 vjetësh nga data e regjistrimit të veprimit të fundit;

i) organizon dhe merr pjesë në veprimtari të kualifikimit profesional me institucione publike dhe financiare, lidhur me çështje të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”.

Neni 10

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave

1. Krijohet Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Parandalimit dhe Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

2. Ky Komitet drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij: Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Rendit Publik, Ministrin e Financave, Ministrin e Drejtësisë dhe Kryetarin e Shërbimit Informativ Shtetëror.

3. Komiteti mbledhet të paktën dy herë në vit dhe ka për detyrë të përcaktojë drejtimit e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, të shqyrtojë dhe analizojë raportet 6-mujore të veprimtarisë së kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, raporte dhe dokumente të përgatitura nga institucione dhe organizma ndërkombëtarë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, si dhe të diskutojë çështje të tjera të rëndësishme që çmohen nga Kryeministri, Prokurori i Përgjithshëm dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

4. Në mbledhjet e këtij Komiteti mund të thirren për të marrë pjesë ministra, deputetë, drejtues ose përfaqësues të institucioneve, si dhe specialistë të fushës së parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave.

5. Rregullat e hollësishme për organizmin dhe funksionimin e këtij Komiteti parashikohen në Rregulloren e Brendshme të tij, të miratuar nga mbledhja e tij.”

Neni 11

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Bashkëpunimi me autoritetet e zbatimit të ligjit

Në zbatim të këtij ligji, çdo subjekt i tij është i detyruar të marrë masa për të siguruar bashkëpunimin me organet shtetërore kompetente. Njoftimi nga subjektet, përfshirë këtu punonjësit e tyre, i të dhënave, sipas kërkesave të këtij ligji, nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore që parashikojnë detyrimin për të mos bërë publike të dhënat për klientët e tyre.”.

Neni 12

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10

Raportimi i organeve doganore

1. Organet doganore identifikojnë klientët e tyre, sipas procedurave të parashikuara në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave.

2. Organet doganore ngarkohen me zbatimin e kërkesave të përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji.

3. Individët, rezidentë ose jorezidentë, kur hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë shumat në të holla, çdo lloj çeku bankar, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlera e kësaj shume në monedha të tjera.

4. Format dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave."

Neni 13

Pas nenit 10 shtohen nenet 10/1 dhe 10/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1

Raportimi i organeve tatimore

1. Organet tatimore identifikojnë klientët e tyre, sipas procedurave të parashikuara në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave për:

a) shërbimet financiare:

i) dhënia, negociimi dhe marrja e huave, të kredive, çdo sigurim për paratë dhe çdo siguracion prej dhënësit;

ii) transaksionet për llogaritë bankare, pagesat, transferimet e borxhit çequet;

iii) transaksionet për monedhën, bankënotën dhe paratë, si mjete të ligjshme pagese;

iv) transaksionet për aksionet, kapitalet financiare, obligacionet dhe letrat me vlerë;

v) administrimi i fondeve të investimeve;

vi) transaksionet për sigurimet, duke përfshirë edhe risigurimet;

b) faturat e përgatitura nga blerësi;

c) deftesat dhe kuponat tatimorë.

2. Organet tatimore ngarkohen me zbatimin e kërkesave të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji.

3. Forma dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 10/2

Raportimi i organeve që licencojnë personat fizikë dhe juridikë

Organet që bëjnë licencimin e:

a) subjekteve të përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "e", "ë", "f", "g", "h" dhe "j" të nenit 3 të ligjit;

b) shoqërive tregtare dhe/ose institucioneve të tjera, që nuk janë përcaktuar si subjekte në nenin 3 të këtij ligji;

identifikojnë personat fizikë dhe juridikë, që kërkojnë të licencohen, sipas kërkesave të nenit 4

të këtij ligji, dhe raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo dyshim për pastrimin e parave dhe për veprime financiare mbi vlerat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji.

Format dhe procedurat e identifikimit dhe raportimit caktohen nga Këshilli i Ministrave pasi të ketë marrë mendimin e Ministrisë së Financave.”.

Neni 14

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11

Raportimi për veprimtaritë bankare

Bankat dhe subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë njoftojnë autoritetin përgjegjës për të gjitha rastet e dyshimta për pastrim parash dhe për veprimet mbi shumat e parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji në këto veprimtari bankare:

- a) Transaksionet në llogaritë e kapitalit:
 - i) investimet e drejtpërdrejta;
 - ii) veprimet me letra me vlerë;
 - iii) transaksionet e kreditit;
 - iv) transaksionet e depozitave ndërbankare;
 - v) transaksionet e sigurimit jashtë territorit dhe jashtë juridiksionit të Republikës së Shqipërisë, kur këto veprime lejohen nga legjislacioni shqiptar.
- b) Transferimi i kapitalit nga shtete të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- c) Transferimi i kapitalit nga territori i Republikës së Shqipërisë në shtete të tjera.
- ç) Transaksionet korrente.
- d) Transferimet e njëanshme të kapitalit:
 - i) transferimet personale të aktiveve;
 - ii) transferimet fizike të aktiveve.
- dh) Investimet e jorezidentëve në letrat me vlerë.
- e) Llogaritë e rezidentëve jashtë vendit.
- ë) Llogaritë e jorezidentëve.
- f) Transaksionet e pagesave me jashtë.”.

Neni 15

Në nenin 13, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Autoritetet mbikëqyrëse të subjekteve, të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse përmbushin edhe këto detyrime:

- a) veprojnë në përputhje të plotë me programet kundër pastrimit të parave;
- b) kontrollojnë zbatimin e programeve kundër pastrimit të parave dhe sigurohen se ato janë të përshtatshme;
- c) hartojnë dhe ndihmojnë në hartimin e udhëzimeve ose të rregulloreve për zbulimin e rasteve ose të sjelljeve të dyshimta të klientit;
- ç) marrin masa për hartimin dhe zbatimin e rregullave të nevojshme për ruajtjen nga kontrollet, përvetësimet, depërtimet ose ndërhyrjet në subjektet që mbikëqyrin, nga ana e grupeve, të elementëve kriminalë ose të bashkëpunëtorëve të tyre;
- d) bashkëpunojnë dhe japin ndihmë të specializuar në rastet e ndjekjes dhe të hetimit të pastrimit të parave, sipas kërkesave të autoriteteve përkatëse;
- dh) njoftojnë autoritetin përgjegjës për çdo rast të dyshimeve për pastrim parash dhe atyre të parashikuara në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji;
- e) bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit në fushën e luftës kundër pastrimit të parave.”.

Neni 16

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14

Kundërvajtjet administrative

1. Nëse nuk përbëjnë vepër penale janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 10 (dhjetë milionë) lekë, shkeljet nga subjektet e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji, në rastet e mëposhtme:

a) mospërbushja e veprimeve dhe procedurave të identifikimit të klientëve, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2 dhe 4 të nenit 4 të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) mosmbledhja e të dhënave dhe mosraportimi tek autoriteti përgjegjës, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 5 të këtij ligji;

c) mosparashikimi dhe moskrijimi i strukturave, sipas pikës 1 shkronjat "a", "c", "e", "ë", "g" dhe pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji;

ç) mosruajtja e të dhënave rreth identifikimit dhe raportimit, në kundërshtim me nenet 4 pika 3 dhe 6 pika 1 të këtij ligji;

d) kryerja e veprimeve në kundërshtim me pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji;

dh) kryerja e veprimeve financiare në kundërshtim me urdhrin e dhënë nga autoriteti përgjegjës, sipas shkronjës "ë" të nenit 8 të këtij ligji;

e) fshirja, prishja ose ndryshimet në regjistrat, që përmbajnë të dhëna për subjektin, në zbatim të këtij ligji.

2. Kundërvajtjet administrative, të kryera nga punonjësit e punësuar pranë subjekteve të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

3. Kundërvajtjet administrative, të kryera nga drejtuesit e nivelit të lartë të subjekteve ose nga përfaqësuesit e caktuar nga subjektet, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 7 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

4. Masa e gjobës vendoset nga drejtuesi i autoritetit përgjegjës.

5. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 17

Në nenin 15 bëhen këto shtesa e ndryshime:

Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) identifikimin, zbulimin, sekuestrimin ose konfiskimin e mjeteve dhe të produkteve të veprave penale, që lidhen me pastrimin e parave;"

Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) ngrirjen ose bllokimin e pasurive, të të ardhurave dhe të instrumenteve, që përbëjnë produkt të veprës penale, subjekt të konfiskimit, për të parandaluar çdo marrëveshje transferimi ose disponimi të tyre;"

Pas shkronjës "b", shtohen shkronjat "c" dhe "ç" me këtë përmbajtje:

"c) ndihmë për zhvillimin e hetimeve të përshtatshme;

ç) ndihmë në identifikimin dhe gjetjen e burimit të produkteve të veprës penale, të sendeve, që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale, të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale ose të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i përgjigjet asaj të produkteve të veprës penale dhe që është objekt konfiskimi."

Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1 Autoriteti përgjegjës shkëmben të dhëna me autoritetet homologe dhe me organizmat ndërkombëtarë, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, për ruajtjen e të dhënave të jetës private."

Në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 15 të ligjit fjala "simotra" zëvendësohet me fjalën "homologe".

Neni 18
Dispozita kalimtare

Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në përputhje me detyrimet përkatëse, autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji duhet të miratojnë dhe të zbatojnë rregullat e brendshme të kërkuara sipas nenit 7 pika 1 shkronja "c" dhe "g", si dhe nenit 13 shkronjat "c" dhe "ç" të këtij ligji.

Neni 19
Dispozita e fundit

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3887, datë 10.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9085, datë 19.6.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 "KODI I
PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 e pika 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7905, datë, 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pika 3 e nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

"3. Gjykatat e apelit për krimet e rënda shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e krimeve të rënda."

Neni 2

Pika 1 e nenit 187 ndryshohet si më poshtë:

"1. Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes."

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 209, pas fjalës "letra" shtohen fjalët "letra me vlerë".

Neni 4

Në nenin 210, pas fjalës "tjetër" shtohen fjalët "edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë".

Neni 5

Pika 2 e nenit 274 ndryshohet si më poshtë:

"2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal."

Neni 6

Pika 3 e nenit 424 ndryshohet si më poshtë:

"3. Për ankimin e bërë kundër vendimeve të gjykatës për krimet e rënda vendos gjykata e apelit për krimet e rënda."

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3890, datë 10.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J

Nr.9086, datë 19.6.2003

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.1.1995 "KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 e pika 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas shkronjës "g" të nenit 7, shtohet shkronja "h" me këtë përmbajtje:
"h) - pastrimi i produkteve të veprës penale."

Neni 2

Në nenin 29 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Dënimi me burgim dhe gjobë jepen bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi."

Neni 3

Pika 2 e nenit 30 ndryshohet si më poshtë:

"2. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale."

Neni 4

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 36

**Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale
dhe produkteve të veprës penale**

1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:

- a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;
- b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;
- c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale;
- ç) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale;
- d) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë vepër penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi.

2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.

4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale."

Neni 5

Pas nenit 124 shtohet nenit 124/a me këtë përmbajtje:

"Neni 124/a

Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit

Kërkimi, propozimi, dhënia ose pranimi i shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me procesin e birësimit të një të mituri, dënohen me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 3 milionë lekë."

Neni 6

Pas nenit 179 shtohet neni 179/a me këtë përmbajtje:

"Neni 179/a

Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë

Mosdeklarimi, në hyrje ose dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, i shumëve në të holla, i çdo lloj forme të çekut bankar, metaleve ose gurëve të [çmuar, si](#) dhe i sendeve të tjera me vlerë, përtej vlerës së parashikuar nga ligji, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet."

Neni 7

Pas nenit 230 shtohet nenit 230/a me këtë përmbajtje:

"Neni 230/a
Financimi i terrorizmit

Financimi i terrorizmit ose mbështetja në çdo formë e tij dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm dhe me gjobë nga 5 milionë lekë deri në 10 milionë lekë.”.

Neni 8

Neni 287 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 287
Pastrimi i produkteve të veprës penale

1. Pastrimi i produkteve të veprës penale i kryer nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, që dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen ose zhdukjen e origjinës së paligjshme të pasurisë ose dhënien e ndihmës për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave të tjera, që lidhen me pasurinë që është produkt i veprës penale;

c) kryerjes së veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas ligjit për pastrimin e parave;

ç) fitimit, zotërimit ose përdorimit të pasurisë, kur dihet që është produkt i veprës penale;

d) këshillimit, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër,

dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë.

2. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 800 mijë lekë deri në 8 milionë lekë, ndërsa kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 3 milionë lekë deri në 10 milionë lekë.

3. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në rastet kur personi, që ka kryer veprën prej së cilës burojnë produktet e veprës penale, nuk mund të merret i pandehur, nuk mund të dënohet, ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose mungon njëri nga kushtet e procedimit penal për një vepër të tillë.”.

Neni 9

Neni 287/a ndryshohet si më poshtë:

"Neni 287/a
Çelja e llogarive anonime

Çelja e depozitave ose e llogarive bankare, anonime ose me emra fiktivë, dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me gjobë nga 200 mijë lekë deri në 2 milionë lekë. ”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3891, datë 10.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr.3875, datë 2.7.2003

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

D E K R E T O J:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Rosalba di Fiore (Lule Russo)	6. Sebije Taip Popoviq
2. Vesel Rifat Sadiku	7. Arben Fadil Popoviq
3. Burim Sulajmon Lokaj	8. Ronald Markus Meier
4. Lulmaj Mentor Sefedini	9. Suliman Ejup Ziberi
5. Fadil Elez Popoviq	10. Maije Aqif Ziberi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr.3876, datë 2.7.2003

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

D E K R E T O J:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Shqipe Muharrem Zenelaj	11. Elida Ismail Xhaferi (Shahini)
2. Saimir Ismail Zenelaj	12. Doris Besnik Xhaferi
3. Albano Ismail Zenelaj	13. Zaran Qiro Stanajevski
4. Agron Brahim Zenelaj	14. Violeta Nikolla Stanajevski (Mastaka)
5. Stivi Agron Zenelaj	15. Zorica Zaran Stanajevski
6. Stela Agron Zenelaj	16. Pëllumb Murat Shpata
7. Suzane Tahir Zenelaj (Kryeziu)	17. Majlinda Ferat Shpata
8. Astrit Brahim Zenelaj	18. Olger Pëllumb Shpata

9. Arben Brahim Zenelaj	19. Klejda Pëllumb Shpata
10. Besnik Halid Xhaferi	

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr.456, datë 3.7.2003

**PËR STRUKTURËN DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS
SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar dhe të pikave 4 e 6 të nenit 2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe niveli i pagës për punonjësit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1 – Diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.
 3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 3) të jetë në masën 2 për qind, pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 4. Shtesa për kualifikim (kolona 4) është 0.
 5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës të lidhjes nr.1.
 6. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase të bëhet në përputhje me lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 7. Punonjësit e tjerë të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët nuk përfshihen në lidhjet nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi, të pagohen sipas lidhjes II-30 “Niveli i pagës për punonjësit e administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe sipas lidhjes II/M “Paga bazë, sipas klasave për punonjësit e ministrave, të institucioneve të tjera qendrore, të ATSH-së, të prefekturave dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
 8. Niveli i pagës për emërtesën “sekretar i Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të jetë në nivelin e pagës së punonjësve të kategorisë III-a, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

Paga mujore					
Klasa	Kategoritë	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
I	I-a	9000	2%	0	74 000
II	II-a	9000	2%	0	55 000
II	II-b	9000	2%	0	40 000
III	III-a	9000	2%	0	30 000

Lidhja nr.2

Klasifikimi i vendeve të punës

Klasa I: është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I-a Drejtor drejtorie

Klasa II: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe të opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu edhe zgjidhjen e problemeve komplekse, që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

II-a përgjegjës sektori

II-b përgjegjësi i sektorit

Klasa III: Kjo klasë merret me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III-aspecialist

V E N D I M

Nr.457, datë 3.7.2003

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKËPTIMIT DHE TË BASHKËPUNIMIT “PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2003”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Memorandumit të Mirëkëptimit dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, që, si përfaqësues i Këshillit të

Ministrave për nënshkrimin e këtij Memorandumi, të ndjekë zbatimin e detyrimeve që përcaktohen në të.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MEMORANDUM **MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI**

“PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2003”

Sot më datë , 2003 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Ben Blushi, Ministër i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga zoti Ilirjan Celibashi, të quajtura Palë këtu dhe më poshtë, nënshkruhet ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi.

Palët në këtë Memorandum bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i këtij Memorandumi është angazhimi i Palëve, në përputhje me detyrimet përkatëse kushtetuese dhe ligjore respektive, për përgatitjen dhe organizimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003.

Neni 2

Palët në këtë Memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin tjetër. Në këtë kuptim, Këshilli i Ministrave dhe organet e varësisë, autoritetet vendore duhet të mbështesin KQZ-në në:

- Financimin e procesit zgjedhor sipas vendimeve të KQZ-së, si dhe mbështetje të menjëhershme me akte nënligjore për realizimin e procedurave të shpenzimeve buxhetore.

- Sigurimin e ambienteve të përshtatshme të punës për KZQV-të dhe qendrave të votimit sipas akteve të KQZ-së.

- Sigurimin e pajisjeve të nevojshme për punë dhe për komunikim për KZQV-të dhe qendrat e votimit (linjë telefonike, orëndi zyre të domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor).

- Sigurimin e ambienteve që janë në administrim të njëjësive përkatëse të qeverisjes vendore për trajnimet që KQZ-ja do të organizojë për komisionet e KZQV-ve dhe KQV-ve. Sigurimi i këtyre ambienteve në numër dhe në ditë të realizohet sipas kalendarit të paracaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

- Angazhimin e strukturave të organeve të qeverisjes vendore për transportin e bazës materiale, dokumentacionit zgjedhor dhe të komisionerëve lokalë, si dhe mbështetjen e KQZ-së me mjete të ndryshme të transportit, mbi bazë të kërkesës së saj, nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, gjatë gjithë procesit zgjedhor.

- Caktimin e vendeve për shpalljen e listave paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve për çdo qendër votimi.

- Angazhimin e zyra të gjendjes civile, sekretarëve të këshillave të bashkive e komunave (që njëkohësisht janë edhe sekretarë të KZQV-ve), si dhe punonjësve të administratës për rishikimin e listës së zgjedhësve të 24 qershorit 2001, duke u bazuar në nenin 154 pika 3 të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” dhe disponibilitetin për administrimin e rregullt të procesit zgjedhor.

- Nxjerrjen e akteve nënligjore për aspekte, të cilat lidhen me përgatitjen e listës së zgjedhësve, mbi bazë të kërkesës së KQZ-së.

Neni 3

Mbi bazën e akteve të KQZ-së, prefektët dhe administrata që ata drejtojnë, do të sigurojnë:
- realizimin e detyrave të parashikuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi në nivel lokal;
- ndjekjen e punës së zyrave të gjendjes civile në rishikimin e listës së zgjedhjeve të 24 qershorit të vitit 2001 nëpërmjet regjistrit civil të shtetasve në nivel lokal.

Neni 4

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga ky Memorandum, Palët veprojnë në bazë të kompetencave që u njeh ligji. Në këtë kuadër, Palët njohin rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përgatitjen e zgjedhjeve, si dhe angazhimin e posaçëm në emër të Qeverisë, të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, për të realizuar angazhimet që burojnë nga ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi.

Neni 5

Ky Memorandum, hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, 2003

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
Ben Blushi
Ministër i Pushtetit Vendor dhe i
Decentralizimit

PËR KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi
Kryetar i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve

V E N D I M
Nr.20, datë 2.7.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Zija VuciAnëtar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred KaramuçoAnëtar i “““
Kristofor PeçiAnëtar i “““
Kujtim PutoAnëtar i “““
Xhezair ZaganjoriAnëtar i “““
Petril PlloçiAnëtar i “““
Sokol SadushiAnëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 22.4.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.21 Akti që i përket:

Kërkues:SHOQËRIA “Y.Y.A.C.D” sh.p.k., përfaqësuar nga zoti Ilirjan Kokeri, administrator i Shoqërisë dhe avokate Merita Tabaku, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SELAM TAKA
2. DILAVER BAJRAMI

3. FAZLLI CERENISHTI

4. QEMAL GJOKUTAJ

5. PELLUMB BALILI

6. BEQO BEJKO, të gjithë të përfaqësuar nga avokat Remzi Kruja, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.1458, datë 20.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1006, datë 24.9.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1952, datë 19.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se në të tri gjykatat është zhvilluar proces i parregullt ligjor, duke argumentuar antikushtetutshmërinë e vendimeve të tyre në këto drejtime kryesore:

Së pari: Gjykata e shkallës së parë, si dhe gjykata e apelit kanë disponuar tej objektit të kërkesëpadisë, duke shkelur në këtë mënyrë nenet 6, 28, 185 të Kodit të Procedurës Civile si dhe duke cenuar elementet e procesit të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Së dyti: Është shkelur parimi i paanësisë në gjykim dhe barazia e armëve, sepse në vendimet gjyqësore janë analizuar vetëm provat dhe pretendimet e paditësve, kurse provat e kërkuesit nuk janë analizuar dhe as nuk janë kundërshtuar.

Së treti: Ka pasur shkelje procedurale në gjykimin në shkallë të parë dhe në apel, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në procesin gjyqësor.

Së katërti: Të gjitha këto probleme janë anashkaluar në mënyrë të njëanshme edhe në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, gjë e cila rezulton në ndarjen 3 me 2 të tij në vendimmarje.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1458, datë 20.4.2001 ka pranuar padinë e paditësve (subjekteve të interesuara) duke e detyruar Shoqërinë "Y.Y.A.C.D" sh.p.k., të paguajë dëmin që shkon afërsisht nga 6000-8000 dollarë për secilin; ka rrëzuar padinë për kushtin penal dhe fitimin e munguar; ka detyruar të paditurin të bëjë riparimin e ballkoneve për secilin paditës, si dhe ka detyruar të bëjë kalimin në pronësi të paditësve të apartamenteve të banimit dhe regjistrimin e tyre në hipotekë.

Gjykata e Apelit Tiranë, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke e ndryshuar vetëm për fitimin e munguar dhe për kushtin penal. Kështu, ka detyruar shoqërinë që të paguajë ndaj të gjithë paditësve fitimin e munguar në shumën afërsisht 400.000 lekë deri në 450.000 lekë për secilin, ndërsa për dy prej tyre, ka pranuar kushtin penal në shumën 1.030.870 dhe 2.580.480 lekë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Paraprakisht, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se të dyja pretendimet e para që parashtrojnë kërkuesi dhe që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit dhe të barazisë së armëve në proces, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në gjykimet kushtetuese të kësaj natyre, kur janë konstatuar raste të tejkalimit nga ana e gjykatave të kërkesave të parashtuara në një padi ose të vendosjes së njëres palë në një pozitë të disfavorshme në raport me palën tjetër, ndërkohë që kjo pabarazi është reflektuar edhe në arsyetimin në mënyrë të njëanshme të argumentave dhe të provave të paraqitura nga palët, ato janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si elementë thelbësorë që prekin parimin e paanësisë në gjykim dhe cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke iu referuar rastit në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk e kanë respektuar parimin e paanësisë në gjykim. Shkelja e këtij parimi kushtetues konsiston në faktin se të dy gjykatat, kanë disponuar tej kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen midis palëve duke u shprehur edhe për ato që nuk janë kërkuar nga pala paditëse.

Kërkesë padia ka pasur për objekt detyrimin e palës së paditur të dorëzojë apartamentin, duke përmbyllur detyrimet kontraktore në shumën 500.000 lekë për secilin, ndërsa gjykata e shkallës së parë e ka tejkaluar atë në disa drejtime. Gjukata ka disponuar tej objektit të padisë, sepse e ka detyruar kërkuesin të bëjë kalimin e pronësisë dhe regjistrimin e apartamenteve në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ndërkohë që një gjë e tillë nuk rezulton e kërkuar shprehimisht nga paditësi.

Kërkimi në objektin e padisë për dorëzim sendi nuk duhet konfunduar me kalimin e pronësisë, sepse për këtë kalim pronësie është e domosdoshme përmbyllja e detyrimeve kontraktore nga palët. Gjithashtu, megjithëse sipas objektit të padisë, rezulton se pala paditëse ka kërkuar përmbylljen e detyrimeve kontraktore në shumën 500.000 lekë, gjykata pa respektuar korrektësisht kërkesat procedurale, që kërkon ligji për shtesën e objektit të padisë, detyron kërkuesin të paguajë tej kësaj shume, si dhe njëkohësisht të kryejë një tjetër punim shtesë që lidhet me riparimin e ballkoneve.

Gjukata e Apelit Tiranë, ka detyruar palën e paditur të paguajë fitimin e munguar për të gjithë paditësit dhe për dy prej tyre edhe kushtin penal, por nuk arsyeton dhe nuk argumenton se në çfarë dispozite ligjore është bazuar për marrjen e një vendimi të tillë, megjithëse një kërkesë e tillë ishte rrëzuar e argumentuar nga gjykata e shkallës së parë me arsyetimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme. Në vendimin e saj, gjykata e apelit, nuk i jep përgjigje argumenteve të parashtruara në kërkesën ankimore nga pala e paditur, duke krijuar dyshime se ajo në zgjidhjen e kësaj çështjeje ka qenë e njëanshme.

Sigurisht që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të analizojë provat dhe faktet se ku janë bazuar gjykatat për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ajo mbetet një detyrë funksionale e gjykatave që zgjidhin çështjen. Megjithatë, Gjukata Kushtetuese në aspektin e kontrollit kushtetues, konstaton se në këtë proces gjyqësor nuk është respektuar parimi i paanësisë në gjykim, që në rastin konkret reflektohet në drejtim të pranimit në mënyrë të njëanshme të kërkesave vetëm të njëjës palë, pa dhënë argumentet ligjore, si dhe të mosdhënies përgjigje dhe të mosanalizimit të argumenteve që ka parashtruar pala tjetër.

Është detyrë e gjykatës së zakonshme që vendimin e saj ta mbështesë mbi mjetet, faktet, dokumentet dhe të gjitha provat e tjera që sjellin palët, por duke i analizuar dhe arsyetuar ato në bazë të ligjit dhe me objektivitet. Në rastin në shqyrtim, vendimi i gjykatës së apelit merret vetëm me pretendimet e palës paditëse dhe nuk arsyeton për t'i rrëzuar si të pambështetura në ligj dhe në prova argumentet e kërkuesit.

Në këto kushte, Gjukata Kushtetuese çmon se pa i hyrë analizës së provave ose fakteve të paraqitura nga palët në gjykim, por duke vlerësuar procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit vetëm në drejtim të respektimit të parimit të paanësisë, ajo konkludon se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjukata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f”, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1458, datë 20.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1006, datë 24.9.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1952, datë 19.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

U D H Ë Z I M
Nr.1, datë 11.7.2003

**MBI PROCEDURAT E RISHIKIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE PËR
ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE, 2003**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 18/1, 41/1 dhe 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

U D H Ë Z O N:

I. Organi përgjegjës për rishikimin e listave paraprake.

i) KZQV-ja është organi përgjegjës për shpalljen, rishikimin dhe miratimin e listave paraprake të zgjedhësve të bashkisë ose të komunës përkatëse.

Ndryshimet në listën paraprake të zgjedhësve bëhen me vendim të KZQV-së.

Vendimet e KZQV-së merren vetëm për:

- heqje nga lista;
- shtim në listën përkatëse;
- korrigjim të të dhënave të zgjedhësve;
- rrëzim kërkesë.

Procesi i rishikimit të listave paraprake fillon me shpalljen e tyre dhe përfundon 23 ditë para ditës së zgjedhjeve.

ii) Për çdo njësi bashkiake të Tiranës dhe lagje administrative të bashkive që kanë të tilla, ngrihet një Qendër e Rishikimit të Listave të Zgjedhësve (QRLZ). Çdo QRLZ përbëhet nga dy punonjës. Për emërimin e tyre vendos KZQV-ja përkatëse me propozim të bërë një nga kryetari dhe tjetri nga zv.kryetari i saj. Punonjësit e QRLZ-së duhet të kenë të paktën arsim të mesëm.

QRLZ-ja pajiset me një kopje të listës model 2 të bashkisë përkatëse dhe materiale të tjera të nevojshme.

QRLZ-ja ndihmon KZQV-në:

1. Në pranimin e kërkesave. Kërkesat regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas modelit të përcaktuar nga KQZ-ja. QRLZ-ja i lëshon kërkesit një vërtetim për marrjen në dorëzim të kërkesës. Ajo i dorëzon kërkesat e bëra me dokumentacionin përkatës në KZQV-në brenda ditës.

2. Në dhënien e informacionit për qënien në listën përkatëse të zgjedhësve, për procedurat e rishikimit dhe për dokumentacionin e nevojshëm.

Orari i punës së QRLZ-ve është çdo ditë 9.00-13-00 dhe 17.00-20.00.

Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të sigurojnë ambiente të përshtatshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së QRLZ-ve.

iii. KZQV-ja duhet të shqyrtojë kërkesën dhe të marrë vendim jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e saj, ose sipas rastit nga përgjigjja e organit kompetent. Kur KZQV-ja e gjen të bazuar kërkesën me dokumentacionin përkatës, vendos pranimin e saj sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

Kur kërkesa nuk është e bazuar, KZQV-ja e rrëzon atë me vendim sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

Vendimi merret me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve me të drejtë vote të KZQV-së.

Vendimi hartohet në 3 kopje. Një kopje ruhet në KZQV së bashku me kërkesën dhe dokumentacionin përkatës shoqërues, një kopje shpallet dhe tjetra dërgohet në KQZ. Kur vendimi është rrëzim kërkesë, hartohet në 2 kopje. Një kopje mbahet në KZQV, ndërsa tjetra shpallet ose i jepet kërkesit, nëse e dëshiron, për ta përdorur për ankimim në gjykatë.

II. Shpallja publike e listave paraprake.

KZQV-ja do të marrë nga KQZ-ja listën paraprake të zgjedhësve në dy modele:

Modelin 1 të listës paraprake të zgjedhësve sipas qendrave të votimit. Kjo listë shërben për të informuar zgjedhësit dhe vendoset në vende publike brenda zonës së qendrës së votimit.

Modelin 2 të listës së zgjedhësve që është e hartuar në bazë komune ose bashkie. Kjo listë do t'i shërbejë KZQV-së, sipas rastit të kërkesës, për të verifikuar ekzistencën e zgjedhësve në të, për të

gjetur QV-në e zgjedhësve brenda komunës ose bashkisë etj.

KZQV-ja shpall listat paraprake sipas çdo QV-je (modeli 1). Së bashku me listat e zgjedhësve KZQV-ja vendos njoftimin mbi vendndodhjen e saj, sipas rastit edhe të QRLZ-ve dhe orarin e punës së tyre.

III. Paraqitja e kërkesës për ndryshime në listën paraprake dhe shqyrtimi i saj.

Kërkesa për ndyshimin e listave paraprake mund të paraqitet bazuar vetëm në një nga shkaqet e parashikuara në rastet e mëposhtme:

a) Zgjedhësi që është në listën paraprake të zgjedhësve ka vdekur.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë:

Familjari, i afërmi i të ndjerit ose një parti politike.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja dhe në çdo rast ajo duhet të firmoset nga personi i cili e paraqet atë kur ai është shtetas.

Kur kërkesa paraqitet nga parti politike, ajo duhet të jetë e firmosur nga drejtuesi lokal i partisë ose një person i autorizuar prej tij.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

- Kërkesë me shkrim shoqëruar me certifikatën e vdekjes, kur është e mundur.

- Kur kërkesa nuk është e shoqëruar me certifikatën e vdekjes, KZQV-ja i kërkon zyrës së gjendjes civile së komunës ose bashkisë, jo më vonë se 24 orë nga bërja e kërkesës, t'i deklarojë gjendjen për personat e kërkuar. Zyra e gjendjes civile duhet t'i kthejë përgjigje KZQV-së jo më vonë se 2 ditë nga paraqitja e kërkesës nga KZQV-ja.

b) Zgjedhësi ka humbur ose nuk e ka të drejtën për të zgjedhur.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë:

Zgjedhësi ose një parti politike.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja. Ajo duhet të jetë e firmosur nga vetë zgjedhësi dhe, kur bëhet nga një parti politike, nga drejtuesi lokal i partisë ose një person i autorizuar prej tij.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

i) Krahas kërkesës për të provuar pretendimin e parashtruar në kërkesë, duhet të paraqitet vendimi i formës së prerë i gjykatës, i cili tregon se personit që është në listën e zgjedhësve, i është hequr e drejta për të zgjedhur, dekreti i Presidentit të Republikës për lënie të shtetësisë shqiptare.

ii) Në rastin kur pretendohet se një person i caktuar, i cili është në listën paraprake, nuk ka mbushur moshën për të votuar, së bashku me kërkesën duhet të paraqitet certifikata e lindjes së këtij personi.

Kur kërkesa nuk është e shoqëruar me certifikatën e lindjes, KZQV-ja i kërkon zyrës së gjendjes civile të komunës ose bashkisë, jo më vonë se 24 orë nga bërja e kërkesës, t'i deklarojë datëlindjen për personat e kërkuar. Zyra e gjendjes civile duhet t'i kthejë përgjigje KZQV-së jo më vonë se 2 ditë nga paraqitja e kërkesës nga KZQV-ja.

c) Zgjedhësi është regjistruar në më shumë se një listë.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë:

Zgjedhësi ose një parti politike.

Në këtë rast, si zgjedhësi, ashtu dhe partia politike, sipas rastit, kanë të drejtë të kërkojnë që të hiqet emri ose emrat (kur kërkesa paraqitet nga parti politike) nga lista paraprake e zgjedhësve.

Kërkesa e zgjedhësit plotësohet sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

Kur kërkesa paraqitet nga partia politike, ajo duhet të jetë e firmosur nga drejtuesi lokal ose një person i autorizuar prej tij dhe detyrimisht duhet të ketë të përcaktuar të paktën njësinë tjetër të qeverisjes vendore në listën e të cilës zgjedhësi është.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi, ai duhet të paraqesë përpara KZQV-së, një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;

- letërnjoftim;

- pasaportë;

- kartë zgjedhësi;

- kur ka një nga këto tre të fundit, dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja, pasi krahasohet me origjinalin, firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur

dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

ii) Kur ka mundësi partia politike, krahas kërkesës, mund të paraqesë dhe një deklaratë noteriale të zgjedhësit në të cilën zgjedhësi deklaron se kërkon të hiqet emri i tij nga ajo listë zgjedhësisht se është në një listë tjetër.

Shqyrtimi i kërkesës dhe marrja e vendimit.

i) Në të dy rastet e mësipërme, c/2(i) dhe c/2(ii), KZQV-ja ka provat e mjaftueshme dhe merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin 1, pika 3 të këtij udhëzimi.

ii) Në rastet kur kërkesa e një partie politike të caktuar, nuk mund të shoqërohet me deklaratë noteriale të zgjedhësit, KZQV-ja cakton me vendim, jo më vonë se 24 orë nga paraqitja e kërkesës, një ose sipas rastit disa grupe verifikimi. Grupi i verifikimit përbëhet nga dy persona të propozuar përkatësisht nga kryetari e zv.kryetari i KZQV-së.

1) Në rast se grupi i verifikimit gjen zgjedhësin, ai duhet t'i marrë atij një deklaratë, nëse do të votojë në njësinë zgjedhore përkatëse. Deklarata është sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja dhe kundërfirmoset dhe nga anëtarët e grupit të verifikimit.

- Nëse zgjedhësi deklaron se nuk dëshiron të votojë në këtë njësi, KZQV-ja përkatëse merr vendim për heqjen nga lista.

- Nëse zgjedhësi deklaron se nuk dëshiron të votojë në njësinë tjetër, KZQV-ja njofton menjëherë me telefon dhe njëkohësisht me shkresë KQZ-në për të marrë masa për heqjen e këtij zgjedhësi nga lista e njësisë tjetër.

2) Në rastin kur grupi i verifikimit, brenda 4 ditësh nga paraqitja e kërkesës, nuk e gjen zgjedhësin, njofton jo më vonë se 24 orë me telefon dhe njëkohësisht me shkresë KQZ-në duke i dhënë të dhënat (emër, atësi, mbiemër, datëlindje) e zgjedhësit dhe emrin e KZQV-së tjetër në listën e së cilës pretendohet të jetë. KQZ-ja brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit me telefon, njofton po me telefon dhe njëkohësisht me shkresë KZQV-në përkatëse të bëjë verifikimin për personin. KZQV-ja në këtë rast vepron sipas pikës së mësipërme c/3(ii)1.

3) Në rastin kur grupi i verifikimit të KZQV-së tjetër, brenda 4 ditësh nga njoftimi i KQZ-së, nuk e gjen zgjedhësin, njofton jo më vonë se 24 orë me telefon dhe njëkohësisht me shkresë KQZ-në. Në këtë rast KQZ-ja, merr vendimin në cilën listë përfundimtare do të ngelet zgjedhësi ose zgjedhësit.

ç) Zgjedhësi ka ndryshuar vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe dëshiron të regjistrohet në listën e vendbanimit ose vendqëndrimit të ri.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja dhe nënshkruhet në prani të përfaqësuesve të KZQV-së.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

i) Kërkesë me shkrim për t'u shtuar në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

ii) Një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;

- letërnjoftim;

- pasaportë;

- kartë zgjedhësi;

- kur ka një nga këto tre të fundit, dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin, firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

iii) Një dokument për të provuar vendbanimin e deklaruar (dokument pronësie nga zyra e regjistrimit të pasurive ose kontratë qiraje për objektin ku qëndron).

d) Zgjedhësi nuk i ka të sakta të dhënat vetjake në listën e zgjedhësve.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

i) Kërkesë me shkrim për të saktësuar të dhënat vetjake në listë.

ii) Një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;

- letërnjoftim;

- pasaportë;

- kartë zgjedhësi;

- kur ka një nga këto tre të fundit, dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin, firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

IV. Dërgimi i vendimeve në KQZ-në.

Vendimet e marra nga KZQV-të për rishikimin e listave paraprake të zgjedhësve, sillen në KQZ, të shoqëruara me një shkresë përcjellëse të firmosur nga kryetari dhe nënkryetari i KZQV-së. KZQV-të e bashkive me lagje administrative dhe të njësive bashkiake të Bashkisë së Tiranës, i sjellin vendimet në KQZ çdo 10 ditë, duke filluar nga data e fillimit të procesit të rishikimit. KZQV-të e tjera i sjellin vendimet e tyre në fund të procesit të rishikimit të listës paraprake, tre javë para datës së zgjedhjeve.

V. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 14.7.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë